



**DREJTORIA E ARSIMIT  
PODUJEVË**

**Nr. 05/406  
17.10.2022**

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 ( Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.90/2010) nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr.04/L – 032, të Ligjit për Arsimin në komunat e Kosovës nr. 03/L-068, Udhëzimet Administrative (MASHTI) nr. 05/2015, Uëzimit Administrativ Nr.137/2020 Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe kërkesave e nevojave për plotësimin e vendeve të lira të punës për mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Podujevës, Drejtoria e Arsimit, ri shpall :

**KONKURS  
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS**

Nr.	Niveli	Pozita	Vendi lirë/Zëvendësim	Numri i pozitave	Nr. i orëve
1	ShMLE	Mësimdhënës/e për lëndë mjekësore për profilin: Teknik Dentar	Vend i lirë	1	20 -orë

**I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit i plotësuar( merret në komunë - Qendra për shërbime me qytetarë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal( letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterzuarra te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit, nuk do të merret parasysh;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

**II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it (UA Nr. 05/2021) , Udhëzimet Administrative të (MASHTI) nr. 05/2015 si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për lëndët mjekësore nga profili :Teknik Dentar në shkollë të mesme të lartë:**

- Specialist i Stomatologjisë
  - Stomatolog
- 
- Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen
  - Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheq 100 pikë apo deri 50% të vlerësimit përfundimtar.
  - Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri 100 pikë apo 50% e vlerësimit përfundimtar.
  - Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në pozitën e lartcekur.
  - Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente ( jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi ).
  - Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuar diplomat nga MASHT.
  - Për intervistë do të ftohen ata kandidat/e të cilët/at i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.
  - Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test, intervistë, si dhe orari i intervistave publikohet në web faqen e komunës së Podujevës <http://kk.rks-gov.net/podujeve> ( konkurset).
  - Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmëri pas përfundimit të procedurave të rekrutimit në këtë konkurs, por në varësi të lirimit të vendit të punës në IEAA (datës së pensionimit, pushimit të lehonisë apo pushimeve tjera të rregulluara me ligj).
  - Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2022-2023. Në rast të ndonjë nevojë eventuale për mësimdhënës/e në IEAA, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave pritëse.
  - Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

### **Afati dhe mënyra e aplikimit**

**Koha e aplikimit** është nga data **17.10.2022** deri me datën **31.10.2022**.

Konkursi publikohet edhe në web-faqen zyrtare të Komunës <http://kk.rks-gov.net/podujeve> po ashtu edhe në tabelën e shpalljeve të objektit të komunës.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për shërbime me qytetarë.

**Drejtoria e Arsimit**  
**Avni Fetahu**

